# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-450042**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Berisha: Nga Kruja inaugurojmë Foltoren e Ripërtëritjes! Koha na thërret t’i japim zgjidhje kësaj gjendje dramatike |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/berisha-nga-kruja-inaugurojme-foltoren-e-riperteritjes-koha-na-therret--i104511` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 17:21:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 17:08:40 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d0424c86fd0a34279e0424b6ab56b34419624ade650e62ab1e1f8e976ffd38ea` |
| TEKSTI | `fd7c68a4aa22cc482cba61130a5eabadd9e2ae9ae7aecf24ab50e6c65820705b` |
| PAMJA | `92119ad11e2cd2ef863d6113926b7bd64deabc06d844dbfa57f037d6fd739471` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8e36b6de979f04fd34679695b4e3a97cdab370af24d548da1c72543b74c91e29` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8e36b6de979f04fd34679695b4e3a97cdab370af24d548da1c72543b74c91e29`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Berisha: Nga Kruja inaugurojmë Foltoren e Ripërtëritjes! Koha na thërret t'i japim zgjidhje kësaj gjendje dramatike

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 19:08




Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha ka marrë pjesë në Kuvendin e degës së Krujës. Gjatë fjalës së mbajtur në këtë takim, Berisha u shpreh se nga Kruja inaugurohet foltorja e ripërtëritjes.

'Foltorja e Ripërtëritjes, por kam kënaqësi që këtë veprimtari, këtë përpjekje të re, e inaugurojmë këtu në Krujë. Dhe nuk ka një vend të dytë ku mund të frymëzojë më shumë se Kruja për një përpjekje të madhe.', u shpreh Berisha.

**Pjesë nga fjala e kreut të PD, Sali Berisha:**

*Demokrate dhe demokratë të Krujës, qytetare dhe qytetarë të këtij qyteti të bekuar, një përshëndetje shumë të përzemërt dhe nderimin më të madh, mirënjohjen më të pakufishme ndaj jush.*

*Por, të dashur aleatë, të dashur deputetë, drejtues i qarkut të Durrësit, anëtarë kryesie, deputet i zonës, deputetë të Durrësit, sot jemi këtu në një ngjarje, në një eveniment shumë të rëndësishëm të demokratëve të Krujës, por dhe të kryetarit të kësaj dege, Aulon Bej Kalaja, të cilin unë duhet ta përgëzoj shumë përzemërsisht.*

*Aulon Kalaja, të themi të vërtetën, u bë pararendësi i atij procesi, i procesit të ripërtëritjes së PD, kaq jetik dhe vendimtar për fatin e kësaj partie, kaq jetik dhe vendimtar për fatin e vendit.*

*Në këtë kuadër, unë duhet t'u them një të vërtetë ju: në axhendën time ekzistonte, ta quajmë Foltorja e Ripërtëritjes, por kam kënaqësi që këtë veprimtari, këtë përpjekje të re, e inaugurojmë këtu në Krujë.*

*Dhe nuk ka një vend të dytë ku mund të frymëzojë më shumë se Kruja për një përpjekje të madhe.*

*Miq, ne si PD kaluam periudha jo të lehta.*

*Por ne sot nuk mund të mburremi as me ato që kaluam, as me ato që bëmë në të shkuarën.*

*Sot koha na thërret t'i japim përgjigje kësaj gjendje dramatike, t'i japim zgjidhje kësaj rrokullisje të madhe, kësaj gjendje dramatike në të cilën e ka katandisur regjimi i Edi Ramës, Shqipërinë dhe shqiptarët.*

*Nuk ka pushtim në histori, që t'i ketë dhënë një goditje më të rëndë qenies shqiptare se sa Edi Rama në 10 vite.*

*Në 10 vite, 47 përqind e shqiptarëve u larguan nga Shqipëria për një shkak madhor, për shkak të vendimit të tij për t'u pasuruar në mënyrë të çmendur, të paligjshme.*

*Për shkak të shndërrimit të financave tuaja, të taksave që paguani jo në rroga, jo në pensione, jo në infrastrukturë, jo në shërbime, spitale e shkolla, por në llogari bankare të fshehura në bankat offshore.*

*Sot qytetari shqiptar nuk mund të imagjinojë, dhe unë njerëzisht u kërkoj ta kujtoni këtë fjalë, se koha do provojë se çfarë Edi Rama u ka bërë shqiptarëve.*

*Asnjë pushtues i egër nuk është sjellë ky ndaj pasurive publike të këtij vendi dhe fondeve.*

*Në një akt amoraliteti total, të vendosur për të plaçkitur gjithçka dhe çdo gjë, pa asnjë kufi, kanë krijuar format më të pabesueshme të vjedhjes së qytetarëve shqiptarë, djersës së tyre të ballit, të vjedhjes së pasurive publike, të shndërrimit të Shqipërisë në një çiflig hajnash që përzënë çdo ditë shqiptarët.*

*Ky shok demografik është goditja më e tmerrshme që kemi marrë ne nga çdo luftë.*

*Kurrë ndonjëherë nuk jemi pakësuar në atë shkallë sa lindjet tona të zbresin në ato të 100 viteve më parë. Asnjëherë nuk është e regjistruar si sot.*

*Unë e kam përjetuar, kam qenë mjek, dhe t'u them të vërtetën ju, e përjetoja me shumë dhembshuri urinë kronike dhe varfërinë ekstreme të njerëzve kur unë u jepja recetën dhe ata nuk e merrnin sepse nuk i blinin dot ilaçet.*

*Kur zona të tëra masive merrnin 1 kg sheqer, bukën dhe 1 kg kripë dhe përjetonin sëmundjen.*

*Atëherë se ishte vendosur hiperkolektivizmi total, i çmendur.*

*Por sot të jemi të sigurt që janë dhjetëra mijëra shqiptarë që numërojnë kafshatën. Që me atë pension që marrin, nuk sigurojnë dot ushqimin normal të dy javëve.*

*Me atë pension që marrin, shkojnë në dyqan dhe gjejnë çmime më të shtrenjta se në Dallas, se në Nju Jork, se në Berlin, se në Romë.*

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 16 Shtator18:31

**"Rama shkoi në Prishtinë për t'i bërë presion Kosovës", Peka: Gjykata Speciale u krijua nën trysni ndërkombëtare**

I ftuar në edicionin e pasdites në Syri TV, Avenir Peka, Ekspert Sigurie, deklaroi se Gjykata Speciale e Kosovës është ngritur si rezul...

POLITIKE 16 Shtator18:08

**BIRN: Institucionet e drejtësisë kundërshtojnë projektligjin për pagat e magjistratëve**

Gjykata e Lartë dhe Prokuroria e Përgjithshme kundërshtuan të mërkurën më 16 shtator projektligjin e ri për pagat e magj...

POLITIKE 16 Shtator17:56

**"Zgjohet" Lulzim Basha dhe reagon për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së**

Nga Lulzim Basha Vendimi i gjykatës speciale është një goditje për të gjithë shqiptarët. Dënimet e shqiptuara ndaj...

POLITIKE 16 Shtator16:36

**PD ripërsërit kërkesën: Kuvendi të miratojë rezolutën për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë**

Partia Demokratike ka ripërsëritur kërkesën që Kuvendi i Shqipërisë të miratojë një rezolutë për d...

POLITIKE 16 Shtator15:59

**Nesër shpallet vendimi për Ilir Metën, ish presidenti: Nuk kam munguar asnjëherë në gjyq**

Është mbajtur seanca në Gjykatën e Apelit të Posaçëm, me relatore gjyqtaren e posaçme Saida Dollani, një proces...

POLITIKE 16 Shtator15:49

**Vendimi i Hagës/ Berisha: Thirrja jonë është për vetëpërmbajtje! Emocionet nuk duhet të ndikojnë në stabilitetin e Kosovës**

Partia Demokratike reagoi kundër vendimit të Gjykatës së Hagës dhe dënimit të ish-drejtuesve të UÇK. Në mble...

POLITIKE 16 Shtator15:30

**Pas Ballukut dhe Ballës, protestuesit kapin "mat" në rrugë edhe Olta Xhaçkën: O hajdute...**

Pasi kanë kapur mat në rrugët e Tiranës Belinda Ballukun dhe Taulant Ballën, protestuesit këtë herë janë për...

POLITIKE 16 Shtator14:22

**"I ka çmendur hajnia"/ Denoncon Berisha: Aeroportin e Vlorës do ia japin Yeffetit! Agasi ka hequr 4 ministra dhe…**

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka hedhur akuza të forta ndaj qeverisë gjatë mbledhjes së grupit parlamentar të PD-s&e...

POLITIKE 16 Shtator13:52

**"Festë në Serbi! U shqyrtuan dosjet e Beogradit"/ Berisha: Ditë e rëndë për shqiptarët, vendimi i Hagës nuk mund ta errësojë luftën e UÇK-së**

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, e ka nisur mbledhjen e grupit parlamentar duke komentuar aktgjykimin e Gjykatës Speciale në Hag&e...

POLITIKE 16 Shtator11:55

**Gjykata e Hagës dënoi ish-krerët e UÇK-së, reagon Rama: Marre!**

Pasi Gjykata e Hagës dënoi me burg ish-krerët e UÇK-së, ka reaguar kryeministri Edi Rama. Përmes një reagimi në rrj...

### ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

AKTUALITET 16 Shtator

**Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...**

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, nd&eu...

KOSOVA 16 Shtator

**Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi**

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

KOSOVA 16 Shtator

**Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...**

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

**Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik**

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video



### Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.